



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.723/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Xhemail Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si të pabazuar apelet e parashtruar nga Xhemail Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me shenjën ZL.An.723/2017, ZL.An.724/2017 të datës 09.11.2017, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë ka pranuar dy apele ZL.Anr.723/2017 dhe ZL.Anr.724/2017 me datë 09.11.2017, nga Xhemail Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, i cili pretendon se në fshatin Smallushë, në Vendvotimin me nr. 1330e, në vendvotimin nr. 1304e, ka pasur keqpërdorime gjatë numërimit të votave pasi që nga komisionerët e vendvotimeve iu janë vjedhur votat e tij.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.723/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për dy apelet që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, vlerësoj se pretendimet ne apel janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apellesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, refuzoj si të pabazuar apelin e apellesit .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.723/2017 më datën 12.11.2017

Kryesuesi i Panelit
Gylene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*